

## **Mbi Auditimin Financiar të Ushtruar në Bashkinë Fier**

Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar të kryer në Bashkinë Fier, me objekt: “Mbi aktivitetit ekonomik e financiar dhe kontrollin e brendshëm, zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet me fonde publike për mallra e shërbime, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj.”, për llojin e auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 245\2 datë 01.03.2013 i ka rekomanduar Z. Baftjar Zeqo, kryetar i Bashkisë Fier, zbatimin e masave të mëposhtme:

### **MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga Bashkia Fier të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën nr. 585/9, datë 06.09.2011.
2. Të merren masa për rregullimin e strukturës organizative dhe të pagave të punonjësve për vitin 2013, mbështetur në kërkesat e lidhjes 4, VKM nr. 1619, datë 02.07.2008, “*Për klasifikimin e funksioneve, grupimin njësisive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore*”, të ndryshuar dhe lidhjes nr. 4, të VKM nr. 598, datë 27.04.2009, të ndryshuar.
3. Në asnjë rast titullari, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të mos veprojnë me fondet buxhetore të Bashkisë, pa përcaktuar saktë më parë destinacionin e tyre dhe vlerën reale të dokumentuar të programeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak.
4. Nga Drejtoria Ekonomike të përcaktohet në programimin e buxhetit kufiri monetar për mallra dhe shërbimeve të ngjashëm duke përcaktuar saktë vjetore dhe vlerën respektive, bazuar në çmimet e publikuara nga INSTAT dhe institucionet e tjera shtetërore përkatëse, apo sipas testimit të tregut të dokumentuar, për të mos përdorur gjatë vitit padrejtësisht, procedurën “*blerje me vlera të vogla*”.
5. Nga Drejtoria Ekonomike të kryhet regjistrimi i çeljes së fondeve nga të ardhurat sipas kritereve të përcaktuara në kapitullin V klasa 7 të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”.
6. Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa, të sistemohen saktësisht në inventar dhe në kontabilitet sipas analizave “*Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara*” kryesisht “*Ndërtesa*”, “*Toka, troje, terrene*”, të cilat prej vitesh paraqiten pa karakteristika, pa emërtime të plota e dimensione ose vetëm me vlerën e rikonstruksioneve e sistemeve të kryera.
7. Të sigurohet dokumentacioni bazë për të gjithë debitorët në shumën 52,793,346 lekë, të analizohen dhe të sistemohen duke nxjerrë përgjegjësinë për mos arkëtimin e tyre. Të kërkohet dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e detyrimeve sipas rekomandimeve të KLSH në vlerën 49,545,042 lekë.
8. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve të merren masa e të vendoset dokumentacioni për përdorimin e karburantit duke filluar nga pasqyrimi i distancave të udhëtimeve ditore në fletët e udhëtimit, nënshkrimet e nëpunësve udhëtues, bazuar në

autorizimet e titullarit në emër të punonjësit që dërgohet me shërbim dhe normave të përcaktuara të konsumit të karburantit sipas librezave të automjetit.

9. Për dy rastet e likuiduara, në shumat 5.000 mijë lekë për vitin 2011 dhe 4.700 mijë lekë për vitin 2012, në total 9,700 mijë lekë, të cilat janë kaluar në llogarinë e Federatës Shqiptare të Futbollit, për pjesëmarrje, bazuar vetëm në aktmarrëveshje pa u shoqëruar me dokumentacionin ligjor, të kërkohet dhe të arkivohet menjëherë dokumentacioni i përdorimit të këtyre fondeve për zbatimin e punimeve (situacioni) që është detyrimisht dhe dokumentacioni justifikues për likuidimet e kryera.

10. Nisur nga financimet e kryera, në shumat 15.500 mijë lekë për vitin 2011 dhe 17.500 mijë lekë për vitin 2012, për zmadhimin e kapitalit për “KS Futboll Apollonia” dhe nga mungesa e kontroleve për përdorimin e pjesës së financimit të Bashkisë, të kërkohet rishikimi dhe rilogaritja e raporteve të kapitaleve duke marrë në konsideratë edhe financimet e kryera nga FSHF në asetet pronë e Bashkisë, si dhe të mos kryhet asnjë pagesë pa u paraqitur dokumentet ligjore justifikuese.

11. Të organizohet puna dhe të bëhen të gjitha veprimet për vlerësimin, regjistrimin në ZVRPP dhe evidentimin në kontabilitet të pronave sipas VKM nr. 574, datë 28.5.2009, shtuar me VKM nr.253 datë 31.3.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në Bashkinë Fier, të Qarkut Fier”, të inventarizohen dhe të pasqyrohen në kontabilitet, duke përgatitur dhe regjistrat përkatës.

12. Nga Bashkia Fier të merren masa për lidhjen e kontratave të punës të punonjësve të Policisë bashkiake, me afat 3 vjeçar, siç përcaktohet në pikën 7 të urdhrin të përbashkët, të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrisë Rendit Publik, nr.01 datë 01.01.2003, “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

13. Nga Bashkia Fier, të shikohet mundësia e shkurtimit të punonjësve të tregut, pasi mbajtja e 2 punonjësve pa patur treg të organizuar dhe me të ardhurat e realizuara, nuk justifikon pagën e 2 punonjësve në vlerën 917,000 lekë.

14. Nga Bashkia Fier, të prodhohen me numër serie, përkatësish Blloqet e Gjobave të Policisë Bashkiake dhe ato të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë, Procesverbalet e konstatimeve, të pezullimit, të vendimeve të gjobave etj. Këto dokumente të administrohen si letra me vlerë duke i inventarizuar dhe regjistruar në kontabilitet, siç përcaktohet në udhëzimin e Ministrisë të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kap IV- Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve.

15. Në pozicionin e Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë, të vendoset një punonjës i arsimuar në fushën e ndërtimit, pasi punonjësi aktual është diplomuar për oficer, Shkolla e Lartë e Bashkuar, në specialitetin artileri kundërajrore, emërim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin e Ndërtimit”, neni 11-“Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor urbanistik”.

16. Nga Bashkia Fier të ngrihet një grup pune me punonjës të Drejtorisë Përgjithshme të Taksave, punonjës të 4 njësite Administrative, punonjës të Urbanistikës, Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Auditit të Brendshëm me qëllim vlerësimin dhe inventarizimin për secilën rrugë e lagje të subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore duke prodhuar hartën e tyre dhe një regjistër elektronik, me të dhënat e nevojshme.

17. Nga Bashkia Fier dhe 4 njësitë Administrative, me përfundimin e kontingjentit të Librezave të popullatës për pagesat e taksave vendore, gjendje në magazinë, për të ardhmen të prodhohen Libreza me shumë fletë, duke bërë përshtatjen e tyre. Arkëtarët e 4 Njësite Administrative të pajisen me vula katrore të thjeshta identifikimi.

18. Nga Bashkia Fier, t’i kërkohet Shoqërisë X shpk, e cila ka implementuar programin kompjuterik, që të kryejë korrigjimet në program, me qëllim që për mos pagesën në afat, subjektet të mos ngarkohen në mënyrë automatike me gjobë në masën 25 %, pavarësisht nga ditët. Në përputhje me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, ku përcaktohet se gjoba për pagesat e vonuara duhet të jetë e diferencuar në masën 5 % në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit.

19. Të përgatitet një studim për riorganizimin e përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave duke riorganizuar Drejtorinë e Kontrollit në Terren dhe Drejtoritë e tjera në përshtatje dhe me programin kompjuterik, si dhe të merren masa për sigurimin e sistemit të krijuar.
20. Bazuar në neni 4, pika 7 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, krahas mbajtjes të dhënave në sistem elektronik:
- Të hartohet regjistri i tatimpaguesve në mënyrë elektronike, për 2040 subjekteve fizike dhe 450 subjekteve juridike.
  - Të hapen regjistrat për familjarët, nga 4 njësitë Administrative (Rajonet) për evidentimin dhe vjeljen e taksës për ndërtesat dhe tarifrat e pastrimit, ndriçimit, dhe gjelbërimit.
21. Nga Drejtoria e Zbatimit të Legjislacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe e Policisë Bashkiake, të merren masa duke propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak paketën me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, sipas kërkesave të neni 6 *“Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”* të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*.
22. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, t’i dërgohen zyrtarisht Policisë Bashkiake, për zbatim urdhrat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë në lidhje me detyrimet tatimore, siç kërkohet në nenin 8 pika 3 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 *“Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”*.
23. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat tatimore”*, të kërkohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit Fier, apo Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, që ndaj subjekteve debitore të vendoset barra siguroese.
24. Ndaj subjekteve të paregjistruar, përveç mbylljes së aktivitetit dhe konfiskimit të materialeve, pasi të merrni edhe mendimin e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve, duhet të vendoset sanksioni me gjobë në masën 25,000 lekë, në zbatim të nenit 112 *“Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim”*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në R.SH”*.
25. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, të merren masa për arkëtimin e 204 subjekteve debitorëve të mbetur më datën 15.03.2013, në vlerën 7,801,471 lekë.
26. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, të merren masa për regjistrimi e 40 subjekteve, duke u ngarkuar me detyrime tatimore për vitin 2013, në vlerën prej 519,517 lekë.
27. Nga Bashkia Fier, të bëhen ndryshime në kontratën e shërbimit të parkimit me pagesë nr. 1357/2, datë 27.12.2011, të lidhur me subjektin X, si më poshtë;
- a. Të ndryshohet neni II, pika 2.2, e kontratës mësipërme ,nga 20 vjet, të lidhet për afatin 5 vjeçar, në përputhje me udhëzimin e ish-MPPTT, nr. 7, datë 10.06.2008 *“Mbi rregullat kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”*.
  - b. Nga Bashkia Fier, pasi të kryhet testimi i realizimit të ardhurave, për secilën rrugë, bazuar në një studim dhe analizën financiare, të ecurisë së këtij shërbimi, të ndryshohet neni III, pika 3, *“Marrëdhëniet Financiare mes palëve”*, të kontratës së mësipërme. Nga kriteri fitim, të vendosen treguesit mbi xhiron e realizuar mujore dhe të kontrollohen nga të dyja palët, e dokumentuar kjo me bileta me numër serie, vendosjen e aparateve matëse, kasa fiskale, etj.
28. Nga Bashkia Fier, të ngrihet një grup pune me punonjës të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, Drejtorisë së Përgjithshme të Urbanistikës, Shërbimeve Publike, Njësie Administrative, etj, duke kryer evidentimin dhe inventarizimin e përgjithshëm të gjendjes të ndërtimeve në qytet, sipas fazave, llojeve të ndërtimeve, strukturës së ndërtimeve pa lejë, duke krijuar një database, me qëllim inventarizimin për secilën rrugë e lagje.
29. Dosjet teknike, që dërgohen nga subjektet e ndërtimit në zyrat e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, të pranohen pasi të jenë protokolluar dhe shoqëruar me listën e përmbajtjes së dokumentacionit. Ndërkohë të kryhet Inventarizimi i dosjeve për gjithë periudhën, të cilat janë gjendje në zyrat e inspektoratit ndërtimor urbanistik siç përcaktohet në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për Arkivat”* dhe rregulloren e nxjerrë për zbatimin e tij.

30. Për të gjitha ankesat e qytetarëve dhe kërkesat e 4 njësive Administrative, të hapet një Rregjistrë më të dhënat përkatëse për pasqyrimin e ankesave të qytetarëve. (*Libri i protokollit të brendshëm të Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik*)
31. Nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik në bashkëpunim me Drejtorinë e Zbatimit të Legjislacionit, bazuar në pikën 16 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor*”, të merren masa për ekzekutimin e 14 gjobave në vlerën 13,680,000 lekë.
32. Të bëhet miratimi i Planit të Ri Rregullues ose riformatimi i planit ekzistuesit në përputhje me ligjin nr.10119, datë 23.04.2009 “*Për planifikimin e territorit*”, për mos pengimin e funksionimit të urbanistikës.
33. Të zbatohet Planit Rregullues gjatë miratimit të lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit sipas ligjit të ri të planifikimit të territorit.
34. Nga Bashkia Fier të miratohet një sistem i rregullave specifike të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010 “*Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, pika b.
35. Kontratat e qirasë që lidhen për objektet që jepen me qira duhet të shoqërohen me dokumentacionin paraprak si: propozimi për veprimtarinë, vendimi i titullarit, genplani i objektit në gjashtë kopje origjinale, sipërfaqja e truallit, të konfirmuar nga prefektura, konfirmimin nga ZRPP për pronësinë shtet të objektit, si dhe nga AKKP për vendimet për njohje ose kthim prone sipas kërkesave të Ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “*Për funksionimin dhe organizimin e qeverisjes vendore*” neni 32, pika c, VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*” dhe Udhëzimin e METE nr. 906, datë 21.11.2011.
36. Nga Drejtoria e Auditimit, të merren masa që në dosjen e auditimit të jenë dokumentet e plotësuar nga audituesit për testet materiale, të përputhshmërisë dhe të kontrollit të brendshëm, vlerësimi mbi metodën e zgjedhjes dhe risqeve që lidhen me to, bazuar në materialitetin, natyrën, shtrirjen në kohë për llogaritë apo transaksionet e veçanta etj.
37. Njësia e Prokurimit, kur harton dokumentet e tenderit për specifikimet teknike, kur është rasti dhe kërkesat për kualifikim, për përcaktimin e të cilave njësia nuk ka kapacitetet e duhura, të kërkojë të përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon.
38. Dokumentet standarte të tenderit në çdo tender të zhvilluar duhet të miratohen nga titullari i autoritetit kontraktor në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreut V, pika 2, germa b, “*Pas miratimit të dokumenteve të tenderit, titullari i autoritetit kontraktor.....*”.
39. Nga KVO gjatë vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë, vërtetimet e lëshuara nga komuna e bashki në të cilat janë regjistruar sipas QKR, për shlyerjen e taksave vendore, të jenë lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës, siç e kërkojnë dokumentet standarde të tenderit.
40. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e shumës 38.146.594 lekë si detyrim i subjekteve ndërtues që në bazë të një Akt-marrëveshje nr.2178/1 datë 04.01.2012 mbajtur midis Bashkisë Fier përfaqësuar nga B.Z dhe subjekteve ndërtues, pa u bazuar në ligj, ju është zbardhur formulari nr. 4 i lejes së ndërtimit pa u paguar më parë taksa e ndikimit në infrastrukturë.

## **MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohej në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **63,630,534 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Shuma 18.000 lekë nga 6 punonjës (L.Z, F.M, F.M, B.Z, H.K dhe A.DH) të cilët kanë përfituar më tepër shpenzime për udhëtim e dieta.

2. Shuma 1,708,173 lekë, e përfituar tepër nga 9 zyrtarë të emëruar Drejtor të Drejtorive të Përgjithshme, (A.DH, F.T, E.Q, L.C, SH.K, M.G, V.T, R.H dhe A.R) për klasifikim në kategorinë I-b në miratim e strukturave organizative dhe pagave të dhëna në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në lidhjen nr. 4 “Klasifikimi i funksioneve të vendeve të punës për nëpunësit civil të bashkive dhe qarqeve dhe të nëpunësve të komunave”, VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27.04.2009 “Për një ndryshim të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008”, dhe të kthehen si më poshtë:

3. Për vlerën 126,884 lekë, tre anëtarët e Komisionit për Prokurim me Vlerë të Vogël, për dëmin ekonomik të shkaktuar si rezultat i kualifikimit të operatorit ekonomik X me çmim të ofertës 775,500 lekë pa TVSH me vlerë më të lartë se çmimi i ofertës të operatorit ekonomik Y me vlerë 648,616 lekë pa TVSH, në prokurimin me vlerë të vogël me objekt “Blerje materiale” dhe “Blerje detergjente”.

4. Në shumën 61.050.251 lekë, si dëm ekonomik, për mos llogaritjen e taksës prej 1% të vlerës së investimit për vitin 2011, përcaktuar sipas nenit 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” si dhe me nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, për subjektet që paraqiten në aneksin nr. 1 dhe nr. 2 që i bashkëlidhen projektraportit.

5. Në shumën prej 157.728 lekë, si dëm ekonomik, duke mos respektuar kufijtë e pronës private dhe miratimin e lejes së ndërtimit për subjektin X ku  $6\text{ m}^2$  e sipërfaqes së ndërtimit është në pronë publike  $6\text{ m}^2 \times 26288$  (VKM nr. 139 datë 13.02.2008) = 157.728 lekë.

6. Në shumën 272,298 lekë nga llogaritja e sanksioneve të parashikuara në kontratë për kamatë vonesat, që në 5 raste subjektet të paguajnë detyrimin, pasi nuk kanë paguar në afat shumën e qirasë për të cilën detyroheshin sipas kontratës.

7. Në shumën 182,340 lekë, sa përfituar tepër nga Shoqëria X si diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfituar më tepër në vlerë në situacion për punimet në objektin “Rikonstruksion i rrugës “Thoma Gallo Fier”.

8. Në shumën 58,900 lekë, nga Shoqëria X sh.p.k., si diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfituar më tepër në vlerë në situacion për punimet në objektin “Rikonstruksion i rrugës “Kostandin Killogjeri Fier”.

9. Në shumën 55,960 lekë, nga bashkimi i shoqërive X sh.p.k. dhe Y sh.p.k., si diferenca në volume pune të pa kryera dhe përfituar më tepër në vlerë në situacion për punimet në objektin “Rikonstruksion i rrugës “Astrit Toto” Sheq i Vogël, Fier”.

### **C. MASA DISIPLINORE**

a. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Fier, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**a. “Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa a për:**

1. E.ZH, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Buxhet – financës.

2. A.DH, me detyrë Drejtore e Drejtorisë Përgjithshme Ekonomike - Moszbatim të plotë të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 kreu II pika 30 “Regjistri i aktiveve”, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” si dhe “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” pikat 95, 96 dhe 109 në kryerjen e inventarëve të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për vitet 2011 dhe 2012

- Nuk ka ndjekur arkëtimet debitore për vitin 2011 dhe 2012, për mos zbatim të nenit 4 dhe 17 të ligjit nr. 10 296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Nuk janë paraqitur si detyrime në bilancet kontabël për vitet 2011 e në vazhdim, shumat e

pa arkëtuara (detyrimet vjetore) nga taksat vendore.

- Ka lejuar të kryhen veprime në mospërputhje me pikën 35 germa “b” të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “dokumente vërtetuese” në financimet për shpenzime për “K.S. Futbollit Apollonia” dhe shpenzime për sistemin e ndriçimit të stadiumit “Loni Papuçiu”.

- Për moszbatim të plotë të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 kreu II pika 30 “Regjistri i aktiveve”, kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” si dhe “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” pikat 95, 96 dhe 109 në kryerjen e inventarëve të aktiveve për vitet 2011 dhe 2012

- Nuk ka zbatuar VKM nr. 1195 datë 5.8.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” pikat 6, 8, 11 dhe 12, duke vepruar padrejtësisht me komisionin dhe procedurën “Për blerjet me vlera të vogla”.

-Nuk ka vlerësuar dhe evidentuar në kontabilitet asetet pronë e Bashkisë si dhe ato të transferuara me VKM “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë”.

3. A.V, Drejtore e Drejtorisë Menaxhimit të Pronave për:

-Mos zbatim të përgjegjësive sipas nenit 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” germa “d”, “dh”, “e” të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” për verifikimin, vlerësimin dhe inventarizimin e objekteve të transferuara me VKM “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë”.

-Nuk ka të dokumentuara veprime për mbikëqyrjen e aseteve të Bashkisë dhe të ndërmarrjeve në vartësi, për kontrollet e ushtruara, konstatimet dhe për masat e marra.

4. L.N me detyrë Specialiste e Kadastrës Urbane për miratimin e planimetrisë së sheshit të ndërtimit dhe mbajtjen e Akt kontrollin në piketimin dhe mbarimin e themeleve të objektit, duke mos paraqitur pronën në realitet.

5. F.T, Drejtor i Përgjithshëm i Taksave;

-Për mos ndjekjen e procedurave ligjore, me pasojë krijimin e debitorëve më datën 15.03.2013 për 204 subjekte në vlerën 7,801,471 lekë, nga të cilat 129 subjekte të biznesit vogël në vlerën 1,982,891 lekë dhe 63 subjekte të biznesit madh në vlerën 5,818,580 lekë.

-Nuk ka kërkuar ndaj subjekteve debitore vendosjen e bares siguruese të Drejtorisë Rajonale të Transportit Fier (për mjetet), apo ZRPP Fier. Në kundërshtim me nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”.

**b. “Largim nga shërbimi civil” neni 25, pika 3 germa “d”** për:

1. M.G, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës në cilësinë e Sekretarit të KRRT-së të Bashkisë Fier (aktualisht specialist në drejtorinë e menaxhimit të projekteve) për zbardhjen e formularit 4 të lejes së ndërtimit në 8 raste pa paguar më parë taksën e ndikimit në infrastrukture duke u bazuar në Akt-Marrëveshje me nr. 2178/1 datë 04.01.2012 “Për shtyrjen e afatit të pagesës së ndikimit në infrastrukturë” duke sjellë të ardhura të munguara për bashkinë Fier në një vlerë prej 39.146.594 lekë. Për mos llogaritjen e për pasojë mos arkëtimin e taksës 1% të vlerës së preventivit, përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, që për vitin 2011 arrin në shumën prej **61.050.251 lekë** dhe përbën dëm ekonomik. Gjithashtu për futjen dhe miratim në mbledhjen e KRRT-së të 2 objekteve shumëkatëshe në një zonë me tipologji ndërtimi (OR) Objekte Rekreative Sportive në kundërshtim me nenin 62 të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” 2 raste të objekteve duke ndryshuar destinacionin e sheshit të ndërtimit.

2. L.C, Drejtor i Drejtorisë Përgjithshme të Zbatimit Legjislacionit për:

- Mos ndjekje të procedurave për ndërhyrje në rrugë ligjore, në të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e të gjithë debitorëve, duke u mjaftuar vetëm në njoftimin e personave, bazuar

në nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” pikat “dh, e, ë, f”.

- Hartimin e Akt-marrëveshjes me nr. 2178/1 datë 04.01.2012 “Për shtyrjen e afatit të pagesës së ndikimit në infrastrukturë” të pa bazuar në ligje dhe që bie në kundërshtim me pikën 3 neni 4 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe nenin 51 të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” si dhe me nenin 9 të ligjit nr. 10078, datë 16.2.2009 “Për disa ndryshime në ligjin për Urbanistikën”.

**c. “Kalimi në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një periudhë 1 vit” neni 25 pika 3 germa “ç” për:**

1. L.S, me detyrë Drejtoreshë e Urbanistikës dhe Kadastrës Urbane, për zbardhjen e formularit 4 të lejes së ndërtimit në 8 raste pa paguar më parë taksën e ndikimit në infrastrukturë, duke u bazuar në Akt-marrëveshjen me nr. 2178/1 datë 04.01.2012 “Për shtyrjen e afatit të pagesës së ndikimit në infrastrukturë” duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Fier në një vlerë prej 39.146.594 lekë. Për mos llogaritjen e për pasojë mos arkëtimin e taksës 1% të vlerës së preventivit, përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, që për vitin 2011 arrin në shumën prej 61,050,251 lekë dhe përbën dëm ekonomik.

2. M.K, me detyrë Drejtore e Regjistrim Vlerësimit

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për vitet 2011-2012, nuk ka hapur, mbajtur, printuar dhe dorëzuar në arkiv, në fund të vitit, me të gjitha të dhënat Regjistrin e 485 tatimpaguesve të Biznesit të madh dhe 1336 tatimpaguesve të Biznesit të vogël, në kundërshtim me nenin 4, pika 7 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

-Për mos ndjekjen e procedurave ligjore, me pasojë krijimin e debitorëve më datën 15.03.2013 për 75 subjekte të Biznesit madh në vlerën prej 5,818,580 lekë, nga ku për vitin 2011 - 15 subjekte në vlerën 1,383,079 lekë, të cilët nuk kanë paguar në masën 35 % dhe 54 subjekte të krijuar gjatë vitit 2012 në vlerën 4,416,247 lekë.

**c. “Kalimi në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një periudhë 6 muaj” neni 25 pika 3 germa “ç” për:**

1. E.Q, me detyrë Inspektore e Biznesit të Vogël;

- Për vitet 2011-2012, nuk ka hapur, mbajtur, printuar dhe dorëzuar në arkiv, në fund të vitit, me të gjitha të dhënat regjistrin e 604 tatimpaguesve të Biznesit të vogël, në kundërshtim me nenin 4, pika 7 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

- Për mos ndjekjen e procedurave ligjore, me pasojë krijimin e debitorëve më datën 15.03.2013 për 43 subjekte të Biznesit vogël në vlerën prej 829,687 lekë.

- Në asnjë rast nuk është bërë rivlerësim në rritje apo ulje i subjekteve të cilët kanë tejkualuar apo nuk kanë realizuar xhiron e deklaruar.

2. P.V, me detyrë Inspektor i Biznesit të Vogël;

- Për vitet 2011-2012, nuk ka hapur, mbajtur, printuar dhe dorëzuar në arkiv, në fund të vitit, me të gjitha të dhënat regjistrin e 732 tatimpaguesve të Biznesit të vogël, në kundërshtim me nenin 4, pika 7 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

- Për mos ndjekjen e procedurave ligjore, me pasojë krijimin e debitorëve më datën 15.03.2013 për 57 subjekte të Biznesit vogël në vlerën prej 700,401 lekë,

- Në asnjë rast nuk është bërë rivlerësim në rritje apo ulje i subjekteve të cilët kanë tejkualuar apo nuk kanë realizuar xhiron e deklaruar.

3. M.SH, me detyrë Inspektore e Biznesit të Vogël

- Për mos ndjekjen e procedurave ligjore, me pasojë krijimin e debitorëve më datën 15.03.2013 për 29 subjekte të Biznesit vogël në vlerën prej 452,803 lekë,
- Për asnjë rast nuk është bërë rivlerësim në rritje apo ulje i subjekteve të cilët kanë tejkaluar apo nuk kanë realizuar xhiron e deklaruar.
- 4. O.P, Drejtore e Kontrollit Tatimor të Terrenit;
- 5. XH.I, Inspektor i Kontrollit Tatimor të Terrenit;
- 6. V.N, Inspektor i Kontrollit Tatimor të Terrenit;
- 7. E.K, Inspektor i Kontrollit Tatimor të Terrenit pasi:
- Programet e kontrollit Tip nuk ishin protokolluar në zyrën e arkivit dhe nuk përcaktonin subjektet që do kontrollohen, tematikën e kontrollit, periudhën e kontrollit, llojin e aktivitetit, etj.
- Të 102 procesverbalet e mbajtuar nga inspektorët e kontrollit, rezultojnë se janë procesverbale TIP, vetëm për konstatimet e kontrollit, dhe nuk kanë evidentuar shkeljet, përshkrimet janë pa referencë të plotë ligjore, blloqet e procesverbaleve të kontrollit, nuk janë me numër rendor, me numër serial, apo të protokolluar në zyrën e arkivit të Bashkisë.
- Për vitin 2011 nga 32 kontrole të kryera, 13 prej tyre nuk janë nënshkruar apo refuzuar nga subjektet. Kurse për vitin 2012 nga 70 kontrole, 20 prej tyre nuk janë nënshkruar nga subjekti i kontrolluar dhe nuk është vënë shënimi refuzon.
- Në asnjë rast nuk është bërë rivlerësim në rritje apo ulje i subjekteve të cilët kanë tejkaluar apo nuk kanë realizuar xhiron e deklaruar.
- Për mos vendosjen e gjobës prej 25,000 lekë, ndaj 41 subjekteve të peregjistruara në QKR.

**d. “Vërejtje me paralajmërim” sipas nenit 25 pika 3 germa “b” për:**

1. E.K, punonjëse e tregut;

-Për mos hartim grafiku për të ardhurat nga tregu, për mos kontroll dhe realizim në nivel të ulët të ardhurave nga biletat e tregut, për 2 vitet 2011-2012, nuk ka mbuluar pagën e saj, për 917,000 lekë. Me pagë mujore 44,000 lekë, ka arkëtuar 138,500 lekë, ndërkohë që është paguar për vlerën 1,056,000 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 81-95 të raportit përfundimtar të kontrollit).

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neni 9 i kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Fier, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

**e. “Vërejtje me Paralajmërim për ndërprerjen e kontratës”, për:**

1. Z.Z, punonjëse e tregut, për mos hartim grafiku për të ardhurat nga tregu, mos kontroll dhe realizim në nivel të ulët të ardhurave nga biletat e tregut, për 2 vitet 2011-2012, si dhe nuk ka mbuluar pagesën e saj për 186,500 lekë pasi është paguar me pagë mujore 24,000 lekë për vlerën 576,000 lekë kur ndërkohë ka arkëtuar 389,500 lekë.

2. H.T, ish-Inspektore e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik për një periudhë 13 mujore, larguar me vendimin nr. 9/4 datë 31.01.2012, aktualisht specialiste në zyrën e Menaxhimit të Pronave në Bashkinë Fier.

3. M.T, Inspektore e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik;

4. R.F, Inspektore e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik;

- Për mos mbajtjen e rregullt të 5 procesverbaleve, në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenin 14 “Mënyra e mbajtjes së procesverbalit apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të, në rastet kur kundërvajtësi kundërshton nënshkrimin e procesverbalit”, ky fakt evidentohet në atë procesverbal. Mangësi të cilat u konstatuan në mbajtjen e 5 procesverbaleve.

- Për mos vendosjen e referencës ligjore të llojit të kundërvajtjes administrative në 353, Procesverbale Kontrolli dhe Konstatimi, të hartuara prej tyre dhe të parashikuara si kundërvajtje në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistiken”, i ndryshuar.



- Për pranimin e dosjeve teknike të dërguara nga subjektet investitorë, të pa shoqëruara me inventarin dhe dokumentacionin që përmban dosja dhe numrin e fletëve.
- Mos shënimin në to të numrit të protokollit, me qëllim dokumentimin e datës së ardhjes së tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe rregulloren e nxjerrë për zbatimin e tij.

**f. “Largim nga puna”** për:

1-P.I, ish-Inspektor për një periudhë 3 mujore, nga data 01.02.2012 deri 30.04.2012, pas kësaj date për 8 muaj me detyrën e Kryeinspektorit (aktualisht mbulon urbanistikën në njësinë administrative nr. 3 në vartësi të Bashkisë Fier).

- Për mos kontroll të mbajtjes të rregullt të 22 procesverbaleve të konstatimit dhe kontrollit, të paraqitura nga Inspektorët në vartësi, në lidhje me mos vendosjen e shënimit për mos nënshkrimin e procesverbalit dhe mos vendosjen e referencës ligjore të kundërvajtjes administrative, të parashikuara si të tilla, në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

- Për mos vendosjen e gjobës për 20 vendimet e prishjes së ndërtimeve pa lejë të vitit 2012, në kundërshtim me pikën 8 të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të teritorit nga inspektoriat ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai Vendor”.

- Për mos nisjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e 14 gjobave në vlerën 13,680,000 lekë, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime.

- Për mos ndjekjen e ecurisë së 13 Kallëzimeve Penale, të dërguara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Nga Bashkia Fier janë pranuar e vënë në zbatim rekomandimet e KLSH dhe është dërguar Plan masash për zbatimin e tyre me shkresë të protokolluar në KLSH nr. 245/11 datë 20.08.2013 dhe 245/13 datë 30.09.2013, ku nuk janë pranuar tre rekomandime për zhdëmtim dëmi për t’u zbatuar, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Vasillaq Peci, Bexhet Zeqiri, Niko Nako, Xhemal Luka, Skënder Hajdari dhe Margarit Stefa, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT